

STATUTI DHE AKT THEMELIMI
i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “GUES AGENCY” sh.p.k

01.03.2025

KREU I
THEMELIMI, ZOTËRIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, SELIA

NENI 1
Ortakët

1.1 Ortaku themelues i shoqërisë është:

- a) **Aldo Hazizaj** shtetas shqiptar, i biri i Vendigjar-it me datëlindje 12.06.1995, lindur në Krujë, banues në Tiranë , mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal J50612060T, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në përputhje me ligjin.

NENI 2
Emërtimi i shoqërisë

2.1 Emërtimi i shoqërisë është **“GUES AGENCY” sh.p.k** (më poshtë referuar si Shoqëria).

NENI 3
Forma Ligjore

3.1 Shoqëria “GUES AGENCY” sh.p.k është “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar”, në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare në Shqipëri.

NENI 4
Selia

4.1 Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, në njësinë nr. 6, Rruga Teodor Keko , Nr. Pasurie:315/2-25 ,.

NENI 5
Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

5.1 Objektet kryesore të veprimtarisë së shoqërisë Agjenci udhëtimesh. Agjenci transporti kombëtar dhe ndërkombëtar udhëtaresh dhe mallrave per vete dhe per te trete, ajror, rrugor dhe detar. Sherbim Taxi. Shitje dhe blerje makinash. Dhënie makina me qera. Agjent në sigurime.

5.2 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve sipas kushteve për ndryshimin e Statutit.

NENI 6

Territori

6.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, ajo mund të hapë filiale, degë, ose përfaqësi në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, apo në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

NENI 7

Kohëzgjatja

7.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të zhvillojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

KREU II

KAPITALI

NENI 8

Kapitali themeltar i shoqërisë

8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 (dhjetë mijë).

8.2 Kuotat do të ndahen në 1 kuotë:

- a) Z. Aldo Hazizaj, është zotërues i 100 % të kapitalit të shoqërisë.

NENI 9

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga Administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

NENI 10

Transferimi i kapitalit

10.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë

- b) shitblerjes
- c) trashëgimisë
- d) dhurimit
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

10.2 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të kalohen të tjerëve plotësisht ose pjesërisht personave të tretë jashtë kësaj shoqërie, por duke respektuar këto klauzola:

- Ortakët kanë të drejtën e parablerjes për kuotat që dëshiron të trasferojë/kalojë
- Ortakët nuk kanë të drejtën e shitjes së kuotave të tij tek të tretë pa marrë më parë miratimin me shkrim nga pala tjetër e ortakërisë
- Ortakët kanë të drejtën e parablerjes së kuotave me të njëjtat kushte dhe të njëjtin çmim me të cilin ortaku mund të ja shiste një personi të tretë kuotën e tij. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga momenti i komunikimit për shitjen ortakët duhet të ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes, në rast të kundërt do të konsiderohet se kanë hequr dorë nga kuota
- Në rast se ortaku që dëshiron të shesë kuotën e tij, ja kalon një personi të jashtëm nga shoqëria me kushte më të favorshme në krahasim me ato të ofruara ortakëve në lidhje me të drejtën e parablerjes nga ana e tyre, atëherë kontrata për kalimin e kuotave që do të nënshkruhet me personin e tretë nuk do të jetë e vlefshme dhe shoqëria dhe ortakët nuk do të japin miratimin për këtë kalim duke u bërë shkak në këtë mënyrë për pavlefshmëri të kontratës së shitjes së kuotave të kapitalit.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

NENI 11

Organi Vendimmarrës

11.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

11.2 Asambleja e Ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statute duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e Ortakut, vendos për çështje si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë
- b) emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar

- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë
- f) miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të asamblesë
- g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- j) marrjen kredi apo hipotekimin e aseteve të shoqërisë
- k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti

Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë
- c) investime
- d) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

NENI 12

Administratori

12.1 Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë.

12.2 Asambleja e Ortakëve emëron një ose më shumë persona fizikë si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Administratori ka të drejtën e administrimit të zakonshëm të shoqërisë.

12.3 Ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e ortakëve.

12.4 Ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë tregtare përpara cdo institucioni publik ose privat.

12.5 Ka të drejtë të përgatisë cdo lloj akti të nevojshëm për ecurinë e shoqërisë dheta depozitojë pranë cdo institucioni publik ose privat sipas ligjeve në fuqi.

12.6 Merret me menaxhimin e përditshëm të shoqërisë duke kryer të gjitha aktivitetet e nevojshme për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personellit; kryen punësimet dhe pushimet nga puna; përcakton udhëzime për kryerjen e detyrave për aktivitetin e shoqërisë; mban korrespondencën e shoqërisë; autorizon blerjen, qiranë e sendeve ose shërbimeve të nevojshme të lidhura direkt ose indirekt me aktivitetin tregtar të shoqërisë; autorizon kryerjen e trasfertave bankare ose tërheqjen e shumave nga llogaritë rrjedhëse të shoqërisë në lidhje me pagesat e pagave ose shpërblimet e punonjësve të shoqërisë; firmos faturat për shërbimet dhe veprimet që shoqëria kryen; kryen të gjitha veprimet e nevojshme përse i përket nënshkrimit të çdo pagese bankare, depozitat, tërheqjet, derdhjet ose trasfertat e ndryshme në llogaritë e shoqërisë të të gjitha llogarive të shoqërisë, pranë cdo banke në të cilën llogaritë janë hapur.

12.7 Përfaqëson shoqërinë në lidhje me cdo kontratë ose marrëveshje me të tretët persona fizike ose juridike, vendas ose të huaj, me intitucione ose ente publike të cfarë do lloji.

12.8 Për administrimin e jashtëzakonshëm të shoqërisë që kalon tagrat e mësipërm administratori duhet paraprakisht të ketë marrë miratimin e asamblesë së përgjithshme.

12.9 Administrator i shoqërisë GUES AGENCY shpk do të jetë Znj. Roven Metaj e bija e Vladimir-it lindur më 14.09.1999 dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal J95914084G e cila do të administrojë aktivitetin e zakonshëm të shoqërisë, me një afat kohor 5 vjet duke filluar nga regjistrimi i shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me të drejtë rinovimi.

KREU IV

EKSPERTËT KONTABËL, VITI FINANCIAR DHE BILANCI, DESTINIMI I TË ARDHURAVE

NENI 13

Viti financiar dhe të ardhurat

18.1 Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor të po atij viti.

18.2 Bilanci vjetor, inventari, raporti mbi ecurinë e aktivitetit tregtar dhe raporti i ekspertit kontabël të autorizuar aprovohen nga Asambleja e Ortakëve.

18.3 Bilanci dhe pasqyrat financiare për vitin financiar duhet të aprovohen brenda 3 muajve nga përfundimi i vitit financiar.

NENI 14

Shpërndarja e të ardhurave

Të ardhurat i shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesëmarrjen dhe kuotat e tyre.

Shoqëria mund të shpërndajë të ardhurat vetëm nëse:

- Aktivitetet e shoqërisë mbulojnë plotësisht detyrimet e tyre;
- Shoqëria posedon aktive në likuiditet të mjaftueshëm për të mbuluar detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve të ardhshëm.

KREU V

PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

NENI 15

Mbyllja dhe likuidimi

20.1 Shoqëria shpërndahet ose priset në cdo kohë në rastet e parashikuara nga ligji ose asambleja e përgjithshme :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve

c) me hapjen e procedurave të falimentimit

d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”

e) me vendim të gjykatës

20. 2 Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

20.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

20.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

20.5 Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 16

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të zgjidhen me marrëveshje në rast se nuk arrihet marrëveshja atëherë kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 17

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Ky statut është mbajtur në 4 kopje në gjuhën shqipe.

Në Tiranë, sot më 01.03.2025, në respektim të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, ndryshuar me ligjin 129/2014, ligjit 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ortakët themelues të shoqërisë hartuan këtë statut dhe akt themelimi të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin GUES AGENCY shpk.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

Aldo Hazizaj